

Në bazë të nenit 51 alinea 12, lidhur me nenin 52 të Statutit të Federatës Bjeshkatore të Maqedonisë së Veriut Nr.01-58/1 dt.15.05.2019, Kryesia e FBMV në mbledhjen të mbajtur në dt.29.04.2021 nxorri këtë:

R R E G U L L O R E

e punës së komisioneve të FBMV

Neni 1

Me këtë Rregullore në detale përcaktohet puna e komisioneve të FBMV, siç janë:

- kushtet e punës së komisioneve,
- metoda dhe mënyra e finansimit,
- mënyra e nxjerrjes së rregulloreve të punës,
- mënyra e punës së komisioneve, etj.

Neni 2

Komisionet dhe fushëveprimi i tyre përcaktohet me Statutin e FBMV.

Neni 3

Në rast nevojë për formimin e ndonjë komisioni për një fushë dhe aktivitet të caktuar të Federatës jashtë komisioneve të caktuara me Statutin e FBMV, Kryesia e FBMV në bazë të nenit 52 të Statutit të FBMV me vendim të veçantë për plotësimin e Statutit të FBMV, formon komision të ri.

Nisma për formimin të një komisioni të ri mund të fillojë edhe me kërkesë me shkrim të një komisioni të krijuar më parë apo prej pesë anëtarëve të Federatës.

Në kërkesë duhet shënuar si më poshtë:

- emri e mbiemri i kryetarit dhe i të gjithë anëtarëve të komisionit;
- përshkrim i sasisë së punës dhe autorizimet e komisionit;
- afati i formimit të komisionit.

Neni 4

Secili komision përbëhet prej pesë anëtarëve.

Me kërkesë të komisionit mund të vendoset rritja e numrit të anëtarëve të komisionit, kuptohet nëse ka shkaqe të arsyeshme për të.

Komisionet kanë organet e veta, siç janë kryetar, këshill drejtues, sekretar, etj.

Neni 5

Kryetarët e komisioneve dhe propozimprogramin e punës së tyre gjatë mandatit që kanë, i zgjedh Kryesia e e FBMV në mbledhjen e parë konstitutive.

Komisionet, rregulloret e të cilave parashohin zgjedhje të kryetarit apo përbërjen e komisionit i zgjedhë organi më i lartë i komisionit (kuvendi i komisionit), detyrimisht brenda afatit prej 30 ditësh pas mbledhjes zgjedhore, dhe vendimin e zgjedhjes ia dërgojnë për miratim Kryesisë së Federatës.

Pas caktimit apo verifikimit të kryetarit të komisionit, kryetari është i detyruar të caktojë mbledhje konstitutive në afat prej 30 ditësh.

Kryetarët e komisioneve propozojnë anëtarë të komisioneve të tyre në bazë të biografive të kandidatëve të marra nga anëtarët e klubeve të Federatës, duke marrë parasysh përfaqësimin territorial nga të gjitha anët e shtetit.

Në komisionet, në rregullativën e të cilëve kërkohet vendim nga organ i më i lartë i komisionit (kuvendit), për anëtarët të komisionit propozohen sipas kandidatët sipas vendimit të organit më të lartë.

Anëtarët e komisionit punojnë vullnatarisht, dhe nëse nuk janë aktivë apo nuk i kryejnë detyrat e dhëna, komisioni mund t'i zëvendësojë.

Me propozim të kryetarit të komisionit për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit Kryesia e Federatës voton si tërësi. Nëse propozimi refuzohet, atëherë të paktën gjysma e të njëjtëve kandidatë mund të nominohen në procedurën e përsëritur.

Në raste se komisioni, rregullativa e të cilit parashef që kryetari apo përbërja e komisionit propozohet nga organi më i lartë i komisionit, vendimin e vet nuk e dërgon për verifikim për përbërjes së komisionit brenda afatit të paraparë, atëherë kryetarin dhe asnetarët e komisionit i zgjedh Kryesia e FBMV.

Neni 6

Komisioni është i detyruar në afat prej 30 ditësh nga konstituimim i tij, të nxjerrë rregulloren e vet të punës, me të cilën në detale i përcakton të gjitha çështjet lidhur me punën e komisionit.

Rregullorja nuk mund të jetë në kundërshtim me këtë Rrregullore dhe me aktet normative tjera të Federatës.

Rregullorja e punës së komisionit dërgohet deri te Kryesia e Federatës për pëlqim dhe aprovim.

Neni 7

Puna themelore dhe detyrat e komisioneve janë si më poshtë:

- përgaditja e programit katërvjeçar të punës;
- përgaditja e programit vjetor të punës me tregues financiarë për periudhën e planifikuar,
- disponimi dhe menaxhimi me buxhetin e komisionit;
- të propozojë projekt-rregullativa dhe akte tjera me të cilat përfshihet fushëveprimi i punës së komisionit apo rregullora e komisionit, të cilat i dërgon për aprovim deri te Kryesia e Federatës;

- nëse është e nevojshme, përgadit propozim për ndryshim dhe plotësim të rregullave të sistemit të punës, dhe i dërgon për aprovim deri te Kryesia e Federatës;
- organizon seminar për trajnim dhe ngritje profesionale të anëtarëve;
- në bazë të raporteve të dërguara për aktivitetet e mbajtura, përgaditen informata gjithëpërfshirëse, të cilat gjithashtudërgon për aprovim deri te Kryesia e Federatës;
- përgadisin kategorizime të klubeve dhe sportistëve deri në fund të vitit kalendarik, në bazë të rezultateve të arritura dhe kriteriumeve të miratuara (kategorizimin e përgadituar ia dërgojnë për aprovim Kryesisë së Federatës);
- ushtrojnë edhe aktivitete tjera sipas konstatimit të Kryesisë së Federatës.

Neni 8

Detyra të komisioneve janë:

- të dërgojnë procesverbale të mbledhjeve të mbajtura deri te Këshilli drejtues më së voni në afat prej shtatë ditësh nga dita e përfundimit të mbledhjes;
- kryetarët e komisioneve të jenë të pranishëm në mbledhjet e Këshillit drejtues, në mbledhjet e seksionit të kuadrave profesioniste të QTS pranë FBMV, dhe, me ftesë, edhe në mbledhjet e Kryesisë së FBMV;
- në përfundim të vitit kalendarik deri te Këshilli drejtues dhe Kryesia e Federatës të dërgojnë raport për aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës së vitit të kaluar;
- në përfundim të vitit kalendarik deri të Kryesia e Federatës të dërgojnë plan për aktivitetet për vitin vijues;
- të dërgojnë procesverbale, raporte nga garat, gjegjësisht për aktivitetet të kryera sipas kalendarit dhe ata publikohen në wep faqen e Federatës, jo më vonë se shtatë ditë pas përfundimit të aksionit a garës;
- të sigurohet transparencë dhe të bëhet publike puna e tyre përmes wep faqes së Federatës;
- Federatës t'ia vejë në disponim materialet e filmuara gjatë realizimeve të planeve vjetore të tyre për nevojat e medie dhe marketingut, për nevojat e arkivit të Federatës, që mund të shfrytëzohen vetëm për atë qëllim;
- të merr pjesë në përgaditjen e materialeve reklamuese të Federatës për mediat publike;
- të bëjnë shpërndarjen e buxhetit në përputhje me programin vjetor të komisionit;
- të ndajnë buxhetin në bazë të kërkesave të arritura për mbështetje të anëtarëve të komisionit apo personave profesionistë.

Neni 9

Komisionet mëvetësishëm i aprovojnë programet e tyre në pajtim me Strategjinë e zhvillimit të sportit në Federatë, me përjashtim kur ndryshe është vendosë nga Kryesia e Federatës.

Komisionet janë të detyruar programet vjetore të veta t'i dërgojnë për miratim deri te Kryesia e Federatës.

Neni 10

Mandati i anëtarëve të komisioneve përkon me mandatin e Kryesisë së Federatës.

Neni 11

Puna e komisioneve zhvillohet në mbledhje të cilat mbahen sipas nevojës, por më së paku një herë në gjashtë muaj.

Caktimi i mbledhjeve bëhet duke e lajmëruar në kohë në zyrën e FBMV.

Për vendimmarrje urgjente anëtarët e komisioneve mund të mbajnë mbledhje për mes internet komunikimeve në rrjetet sociale apo aplikacione të ngjajshme, si dhe për mes telefonit apo postës elektronike t'i shprehen Kryetarit apo personit të autorizuar prej tij. Kryetari a personi i autorizuar është i detyruar të evident,ojë deklaratën, por deklaratën e dhënë deklaruesi në afat prej shtatë ditësh duhet ta dërgojë në formë me shkrim. Nëse deklaratat me telefon dhe ato me shkrim janë të njëjta, vota do të konsiderohet e vlevshme. Tek deklaratimet për mes postës elektronike votimi është i vlevshëm duke e ruajtur dokumentacionin e votimit. Të gjitha korespondencat oficiale që u përkasin punës së komisioneve duhet të janë kryer për mes fahut elektronik zyrtar të komisionit me shfrytëzues dhe kod të konfirmuar që i marrin udhëheqësit e komisionit, të cilat mund t'i shfrytëzojnë edhe persona tjerë të autorizuar nga vetë komisioni.

Nëse komisioni nuk mban mbledhje në periudhë prej një viti dhe për këtë nuk ka arsyetim, komisioni do të llogaritet si joaktiv.

Neni 12

Mbledhjet e komisioneve zakonisht janë publike.

Komisioni mund të marrë vendim për pika të veçanta të rendit të ditës të shqyrtojë dhe të marrë vendim pa praninë e publikut.

Neni 13

Mbledhjet e komisioneve i cakton kryetari sipas nevojës apo me nismë të vet apo me kërkesë të njërit apo më shumë anëtarëve të komisionit.

Me mbledhjet kryeson kryetari apo anëtari i komisionit i emëruar nga vetë kryetari.

Në rast mungese të kryetarit apo në raste kur ai i injron kërkesat e mësipërme të shumicës së anëtarëve të komisionit, kjo shumicë mund të caktojë mbledhje, ndërsa me mbledhjen do të kryesojë anëtari më i moshuar i komisionit, i cili ka të njëjtat të drejta dhe autorizime për zhvillimin e mbledhjes që i ka kryetari.

Neni 14

Mbledhjet e komisionit thirrenme shkresëdhe dërgohen për mes postës elektronike.

Thirrja për mbledhje përmban: vendin, kohën dhe propozim rendin e ditës së mbledhjes.

Thirrja për mbledhje do t'u dërgohet anëtarëve të komisioni më së voni në afat prej shtatë ditësh para mbajtjes së mbledhjes, ndërsa në raste urgjente mundet edhe drejtpërdrej para seancës (p.sh.në rast mbledhjesh me telefon, marrje vendimesh për mes postës elektronike ...).

Bashkëngjitur me thirrjen për mbledhje detyrimisht në tërësi dërgohen edhe materialet që do të shqyrtohen në mbledhje, për mes telefonit apo postës elektronike.

Neni 15

Komisioni mund të marrë vendime të plotëfuqishme nëse në mbledhje janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve.

Neni 16

Kryetari i komisionit i mban mbledhjet në pajtim me dispozitat e Statutit të Federatës dhe të këtaj Rregulloreje, si dhe kujdeset për mbajtjen e rendit të mbledhjes.

Në rast prishje të vrazhdë të rendit të mbledhjesose sjellje në kundërshtim me parimet e moralit bjeshkatar, kryetari i komisionit do t'i japë vërejtje autorit që e ndërpret punën e mbledhjes, dhe, pas vërejtjes së përsëritur atë e largon nga mbledhja, nëse ashtu vendos shumica e anëtarëve të komisionit.

Neni 17

Anëtari i komisionit (diskutuesi) mund të flasë vetëm për pikat nga rendi i ditës.

Nëse diskutuesi nuk i përmbahet rendit të ditës, kryetari i komisionit do ta përkujtojë dhe do t'i bëjë vërejtje për t'iu përmbajtur atij. Nëse diskutuesi vazhdon të mos i përmbahet rendit të ditës, kryetari i komisionit ka të drejtë t'ia ndërpresë fjalën.

Neni 18

Nëse gjatë mbajtjes së mbledhjes nuk ka numër të mjaftueshëm anëtarësh për kuorum, kryetari i komisionit do të japë 30 minuta pushim, pastaj do ta vazhdojë mbledhjen. Anëtarët që mungojnë në vazhdim do t'i dërgojnë vendimet e veta me shkrim.

Neni 19

Anëtarit të komisionit, i cili dëshiron të flasë për shkelje të kësaj Rregulloreje ose për shkelje të rendit të ditës të caktuar, kryetari i komisionit do t'ia japë fjalën menjëherë sapo ta kërkojë.

Neni 20

Kryetari i komisionit mund të propozojë kohëzgjatja e diskutimit të jetë e kufizuar dhe çdo pjesëmarrës mund të marrë fjalën vetëm një herë, nëse vlerëson se diskutimi për tema të caktuara mund të zgjasë më shumë ose kur do të janë paraqitur për diskutim më shumë diskutantë.

Çdo anëtar i komisionit gjithashtu mund të propozojë kufizim të kohëzgjatjes së fjalimit.

Kur kohëzgjatja e fjalimit është e kufizuar, kryetari i komisionit në rast tejkalimi të kohës së caktuar, duhet ta përkujtojë folësin se koha i kaloi, e nëse ai nuk e përfundon fjalimin në minutën në vijim, kryetari i komisionit do t'ia ndërprë fjalimin.

Neni 21

Nëse ndonjë anëtar i komisionit kërkon të merr fjalën për të sqaruar thënjenqë ka të bëjë me të, e cila sipas tij është e pavërtetë, kryetari i komisionit do t'ia japë fjalën menjëherë pasi personi që ka provokuar korrigjimin në fjalë, ta mbarojë fjalën e tij. Anëtar i në fjalën e tij patjetër duhet të përkufizohet në korrigjimin (replikën).

Neni 22

Vendimet merren me votim publik, me ngritje të dorës të anëtarëve të komisionit.

Gjatë kohës së vendimarrjes askush nuk mund të marrë fjalën para se të shpallen rezultatet e votimit.

Neni 23

Komisionet punojnë dhe marrin vendime në mbledhje.

Komisionet marrin vendime me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm, dhe, nëse votat janë të ndara (nuk ka shumicë), vendimtare është vota e kryetarit apo e atij që udhëhet me mbledhjen.

Neni 24

Anëtarit të komisionit mund t'i pushojë mandati edhe para kohe në këta raste:

- me kërkesë me shkrim apo me dorëheqje të vetë anëtarit;
- për shkak të mungesave të paarsyeshme në mbledhje (më së paku tre mungesa të njëpasnjëshme);
- nëse i është shqiptuar ndalesë për pjesëmarrje në punën e organeve dhe trupave punuese të Federatës dhe/ose organeve dhe trupave të klubit;
- nëse ai është përjashtuar nga anëtarësia;
- nëse anëtar i komisionit detyrat e veta nuk i përmbush me ndërgjegje dhe në kohë.

Për këtë komisioni vendos me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Neni 25

Për përgaditjen e mbledhjeve të komisionit përkujdeset kryetari i komisionit me ndihmën e shërbimit profesional të Federatës.

Kryetari i komisionit është i detyruar në propozim-legjendën e mbledhjes t'i përfshijë propozimet me shkrim të anëtarëve të komisionit.

Neni 26

Para fillimit të mbledhjes çdo anëtar i komisionit nëse ka arsye mund të kërkojë të ndryshohet dhe plotësohet propozim-rendi i ditës i propozuar në thirrjen për mbledhje.

Rendi i ditës konfirmohet nga shumica e votave të anëtarëve të pranishëm.

Neni 27

Kryetari i komisionit për secilën pikë të rendit të ditës para hapjes së debatit, i jep fjalën referuesit përkatësisht parashtruesit të propozimit a raportit konkret.

Neni 28

Në mbledhje çdo njëri anëtar i komisionit ka të drejtë të kërkojë fjalën dhe të flasë. Marrja e fjalës kërkohet me ngritje të dorës.

Neni 29

Pasi të ketë mbaruar diskutimi dhe të janë marrë vendimet për të gjitha pikat e rendit të ditës, kryetari i komisionit e mbyll mbledhjen.

Kur për shkat të rendit të ditës të gjërë ose për shkaqe tjera nuk është e mundur të përmbillet diskutimi i të gjitha pikave brendanjë dite, komisioni mund të merr vendim për ndërprerje dhe vazhdimin ta caktojë për një ditë tjetër, në ç'rast me shkrim do t'i njoftojë vetëm anëtarët që mungonin.

Çdo anëtar i komisionit mund të propozojë anulimin e mbledhjes.

Neni 30

Kryetari i komisionit cakton sekretarin e tij, i cili e përpilon me shkrim procesverbalin e mbledhjes, gjithmonë në pajtim me dispozitat e Statutit të Federatës.

Tekstet e vendimit integral i bashkëngjiten procesverbalit.

Teksti origjinal i procesverbalit përpilohen në duplikat dhe e nënshkruajnë kryetari i komisionit dhe procesverbalisti, i cili është nëpunës administrativ i komisionit për komunikim me zyrën e Federatës dhe bashkarisht kujdesen për arkivën e komisionit.

Procesverbali i komisioni detyrimisht u dërgohet Kryesisë së Federatës dhe anëtarëve të komisionit jo më vonë se shtatë ditë pas mbylljes së mbledhjes.

Neni 31

Në rast se Kryesia e Federatës refuzon t'i miratojë programet, raportet, propozimet e anëtarëve të komisionit, Rrregulloren a Protokollin e punës së komisionit që i janë dërguar, për propozimet dhe konkluzat kontestuese do të diskutohet dhe komisionit i dërgohet konkluzë në afat prej shtatë ditësh.

Komisioni në afat prej 10 ditësh do t'i shqyrtojë konkluzën dhe propozimet kontestuese të Kryesisë së Federatës. Qëndrimin e vet ia dërgon Kryesisë së Federatës në afat prej shtatë ditësh.

Nëse Kryesia e Federatës nuk i aprovon konkluzat e komisionit për propozimet kontestuese, e shkarkon komisionit dhe dhe zgjedh kryetar të komisionit në pajtim me procedurën e paraparë me këtë Rregulloore.

Procesverbali me konkluzat dhe vendimet e komisionit që janë me interes për anëtarët e Federatës, pas miratimit shpallet në wep faqen e Federatës.

Vendimet operative me probleme specifike teknike (udhëheqës trajnimi, emërimi i trupave punuese të brendshme, vazhdimi i licensave, etj.) nuk do të publikohen si thuhet më sipër.

Neni 32

Kryetarët e komisioneve kanë të drejtë të dalin para medieve me pajtimime Kryetarit ose Zëvendëskryetarit të Federatës.

Neni 33

Për synime e punës së vet, komisionet shfrytëzojnë shërbimin profesional të Federatës, hapsirat kancelarike dhe paisjen e Federatës.

Neni 34

Për ngjarje sportive, mbledhje, konferenca e tj. të cilat sipas thirrjes mbahen jashtë shtetit dhe kur një individ a klub e përfaqëson Federatën, është i nevojshme vendimi i Kryesia e Federatës.

Neni 35

Mjetet për punën e komisioneve sigurohen nga resurset e rregullta të buxhetit të Federatës, si dhe prej donatorëve dhe sponsorëve.

Mjetet për punën e komisioneve caktohen në bazë të programeve vjetore të komisioneve.

Neni 36

Pas vendimit të Kryesisë, Federata e ka për detyrë mjetet t'ia kalojë në dispozicion komisionit për buxhetin e vitit vijues a më së voni në afat prej 30 ditësh para realizimit të aktiviteteve sipas programit të komisioneve.

Në rast mospagimi të mjeteve në llogarinë rrjedhëse të Federatës, kjo në afat prej shtatë ditësh nga dita e destinimit të mjeteve, do t'i kalojë në disponim komisionit për realizimin e aktiviteteve të parapara në programin e saj.

Shfrytëzimi i mjeteve për aktivitetet e rradhës nuk do të lejohet nëse raportet për aktivitetet paraprake nuk janë mbajtur në mënyrë të rregullt.

Pagesa e shpenzimeve të lejuara kryhet në njërin nga dy mënyrat e mundshme:

1. Pas marrjes së pro-fakturës / ofertës / llogarisë;
2. Pagesë për mes llogarisë rrjedhëse (IBAN).

Shpenzime që nuk janë arsyetuar dhe lejuar nga zyra e Federatës, nuk do të paguhet apo refundohen.

Pagesa nuk bëhen me avancë, me përjashtim të rasteve përkatëse të veçanta, që doemos paraprakisht duhet të janë arsyetuar dhe lejuar nga zyra e Kryesisë së Federatës.

Udhëtim zyrtar është kur përfaqësues të organeve të Federatës në bazë të ftesës formale të pranuar udhëtojnë për në mbledhje të asaj trupe të udhëheqësve të procedurave të komisioneve, instruktorëve dhe trajnerëve tjerë gjatë shkuarjes nëpër shkolla, kurse, provime, gara sportive, etj. Realisht, si udhëtim

zyrta merret shkuarja e ndonjë anëtari në kurs, trajnim a seminar, si dhe pjesëmarrje konkret në shërbim brenda shtetit në aksion konkret.

Në rast dyshimi për natyrën e udhëtimit konkret, vendimin e merr zyra e Federatës.

Udhëtari është i detyruar të paraqesë raport me shkrim dhe ta bashkëngjësë faturën e shpenzimeve materiale (p.sh.taksa e rrugës, shpenzimet e fletjes, etj.) krejt sipas Udhëzimit për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve të Federatës. Për udhëtimet, shpenzimet e të cilave nuk janë llogaritur në kohë të duhur dhe në formë të rregullt, zyra e Federatës e ka të drejtën të ndalojë pagesën.

Neni 37

Mjetet e siguruar nga donatorët dhe sponsorët, komisionet për zbatimin e programeve të veta, ato mjete i derdh në llogarinë rrjedhëse të Federatës apo në një nënlllogari të veçantë të hapur në llogarinë e Federatës. Këta mjete mund të shfrytëzohen vetëm për qëllimin për të cilin janë destinuar.

Në rast mosrealizimi të programeve për të cilat komisioni ka marrë donacione a sponsorime, mjetet i kthehen donatorit a sponsorit që i ka i paguar ose me kontratë të re me donatorin a sponsorin, i ngelin në disponim komisionit ose Kryesisë së Federatës.

Federata nuk mban përgjegjësi ndaj donatorëve a sponsorëve jashtë këtyre rregullave.

Neni 38

Kryetarët e komisioneve të autorizuar prej Kryesisë së Federatës kanë të drejtë të lidhin kontrata me donatorë e sponsorë me detyrim që një kopje të kontratës të dërgojnë në Federatë.

Kryetarët e komisioneve në çdo kohë mund të shiqojnë rrjedhën e bilansit në Federatë për të ndjekë pagesat e donatorëve dhe sponsorëve.

Neni 39

Kryesia e Federatës për llogari të shpenzimeve administrative dhe teknike të zyrës së saj ka në disponim 5 – 10% të shumës së pagesuar nga donatorët e sponsorët.

Neni 40

Të gjithë donatorët dhe sponsorët e komisioneve njëherit janë edhe donatorë të Federatës.

Të gjithë donatorët dhe sponsorët e komisioneve do të rangohen sipas shumës së mjeteve të destinuar për secilin aktivitet të komisioneve dhe do të marrin tretmanin e duhur në reklamat e Federatës.

Neni 41

Pajisjet dhe mjetet të siguruar nga komisionet janë në pronësi të Federatës.

Neni 42

Në rast dorëheqje kolektive të komisionit, kryetari i komisionit është i detyruar të mundësojë punë minimale të komisionit deri në mbajtjen e mbledhjes së rradhës të Kryesisë së Federatës.

Neni 43

Komisionet për punën e tyre mbajnë përgjegjësi kolektive dhe individuale para Kryesisë së Federatës.

Neni 44

Interpretim të dispozitave të kësaj Rregulloreje jep Kryesia e Federatës.

Neni 45

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen në mënyrë dhe procedurë të paraparë si për nxjerrjen e saj.

Neni 46

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e nxjerrjes së saj.

Nr.01-44/3

Federata Bjeshtkatore e Maqedonisë Veriore

Dt.29.04.2021.

Kryetari

Shkup

Prof. D-r Jovica Ugrinovski